

LIGJ
Nr.7628, datë 21.10.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË LIJIN NR. 7585, DATË 14.7.1992 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE"

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7585, datë 14.7.1992 "Për tatimin mbi të ardhurat personale", bëhen këto ndryshime:

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Nga tatimi mbi të ardhurat personale përjashtohen të ardhurat që rrjedhin nga pagat deri në 4000 lekë në muaj".

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Të ardhurat nga pagat mbi 4000 lekë në muaj tatohen si vijon:

1. Kur paga mujore është 4001-5000 lekë, shuma mbi 4000 lekë tatohet 5%.
2. Kur paga mujore është 5001-5500 lekë, shuma nga 4001-5000 tatohet 5% kurse shuma mbi 5001 tatohet 10%.
3. Kur paga mujore është 5501-6500 lekë, shuma nga 4001-5000 lekë tatohet 5 për qind, shuma nga 5001-5500 lekë tatohet 10 %, kurse shuma 5501-6500 lekë tatohet 15%.
4. Kur paga mujore është 6501-8000 lekë, shuma nga 4001-5000 lekë tatohet 5 për qind, shuma nga 5001-5500 lekë tatohet 10%, shuma nga 5501-6500 lekë tatohet 15%, kurse shuma nga 6501-8000 lekë tatohet 20%.
5. Kur paga mujore është 8001-9000 lekë, shuma nga 4001-5000 lekë tatohet 5%, shuma nga 5001-5500 lekë tatohet 10%, shumanga 5501-6500 lekë tatohet 15%, shuma nga 6501-8000 lekë tatohet 20%, kurse shuma nga 8001-9000 lekë tatohet 25%.
6. Kur paga mujore është 9001 e lart, shuma nga 4001-5000 lekë tatohet 5%, shuma nga 5001-5500 lekë tatohet 10%, shuma nga 5501-6500 lekë tatohet 15% shuma nga 6501-8000 lekë tatohet 20%, shuma nga 8001-9000 lekë tatohet 25%, shuma nga 9001-10000 lekë tatohet 30% dhe shuma mbi 10 000 lekë e lart tatohet 40%".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1.10.1992.

Shpallur me dekretin nr.338, datë 29.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.